

PROGRAMI ME KARAKTER PROFESIONAL 2 – VJEÇAR “NDIHMËS EKONOMIST”

Emertimi akademik i studimit	Diplomë Profesionale “Ndihmës Ekonomist”
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	Në proces akreditimi
	Program me karakter profesional
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti Ekonomik, Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	a.Pranimi i studentëve në programet me karakter profesional, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional. b. Në këtë program studimi nota mesatare nuk është kriter pranimi. c. Renditja e kandidatëve fitues kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura. d. Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania).

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit 2-vjeçar “Ndihmës Ekonomist” është të aftësojë studentët me njohuri teorike dhe praktike në fushat bazë të nevojshme për të kuptuar funksionimin e ekonomisë dhe menaxhimin e aktiviteteve financiare në një mjedis real pune. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit:

1. Të marrin njohuritë e nevojshme për formimin e tyre në përvetësimin e njohurive bazë ekonomike, financiare dhe kontabël.
2. Të marrin njohuritë e nevojshme për formimin e tyre në aplikimin e instrumenteve bazë të përlllogaritjeve financiare dhe fiskale.
3. Të kenë njohuritë e nevojshme për formimin e tyre në të kuptuarit dhe përdorimin e sistemeve tatimore dhe raportimit financiar në ndërmarrje.

4. Të kenë njohuritë e nevojshme për formimin e tyre në aplikimin e njohurive teorike në situata praktike përmes praktikës profesionale në fund të ciklit të studimit.
5. Të pajisen me njohuri të nevojshme për formimin e tyre bazë në përgatitjen për pozicionin e ndihmës ekonomistit në institucione dhe biznese të ndryshme.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e ndihmës ekonomistit, një profesionist i aftë për të kontribuar në mjedisin ekonomik dhe financiar të tregut shqiptar të punës, përmes njohurive dhe praktikës profesionale në fusha si: ekonomia, kontabiliteti, financat, administrimi i biznesit dhe sistemi tatimor.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi praktike, analitike dhe komunikuese që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojnë një performancë të lartë në mjedisin ekonomik, financiar dhe administrativ në të cilin studenti i diplomuar do të veprojë si i punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon disiplina në fusha të tilla si ato të ekonomisë së përgjithshme, kontabilitetit financiar, financës dhe administrimit të biznesit, bankave dhe sistemit financiar, etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. **Lëndë të formimit të përgjithshëm:** Bazat e Ekonomisë, E drejta e punës, **Kredite gjithsej: ~ 12 ECTS**
2. **Lëndë të formimit karakterizues:** Instrumenta Kalkuluese në Biznes, Baza Ligjore e Kontabilitetit, Komunikimi në Biznes, Bazat e Financës, Kontabiliteti Financiar, Njohuri mbi Sistemin e Tatim Taksave, Bankat dhe Sistemi Financiar, Kontabiliteti Aplikativ, Llogaritja dhe Regjistrimi i Shpenzimeve, Menaxhim Biznesi, Baza të Marketingut. **Kredite gjithsej: 66 ECTS**
3. **Lëndë integruese:** Njohuri për Programet Financiare, Lëndë me zgjedhje, Hyrje në Informatikë **Kredite gjithsej: 18 ECTS**
4. **Lëndë të formimit plotësues:** Gjuhe e huaj (Anglisht, Frëngjisht, Italisht), Praktika Profesionale **Kredite gjithsej: 18 ECTS**
5. **Detyrime përmbyllëse** **Kredite gjithsej: 6 ECTS**

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	0 në 44 pikë
5 (pesë)	45 - 54 pikë
6 (gjashtë)	55 - 64pikë
7 (shtatë)	65 - 74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë dhe ekspertë të kualifikuar, me aftësi praktike dhe profesionale në fushën e ekonomisë, financave, administrimit të biznesit dhe kontabilitetit, me njohuri të tilla si kontabilitet bazë, përdorimi i mjeteve financiare, njohuritë mbi sistemin tatimor, mbi bankat dhe sistemin financiar, aftësitë komunikuese në mjediset e biznesit, marketing,etj.

Për këtë arsye, synimi i programit të studimit profesional 2-vjeçar “Ndihmës Ekonomist” është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në :

1. Biznese private – si ndihmës në sektorin financiar, kontabël ose të administrimit të brendshëm.
2. Zyra kontabiliteti – si asistentë të kontabilistëve për përgatitjen e dokumentacionit financiar dhe fiskal.
3. Administrata publike lokale dhe qendrore – në pozicione teknike për ndjekjen e procedurave ekonomike e financiare.
4. Shoqata apo OJF– për menaxhimin e buxhetit dhe raportimin financiar të projekteve.
5. Subjekte tregtare (dyqane, agrobiznese, punishte) – për llogaritje kostoje, mbajtjen e arkës dhe regjistrime financiare.
6. Institucione mikrofinanciare dhe banka – si punonjës në front desk, arkëtarë ose ndihmës kreditorë.
7. Agjenci tatimore dhe struktura fiskale– në pozicione ndihmëse për regjistrim tatimor apo asistencë ndaj bizneseve.

8. Fermat apo agrobizneset – për administrim të thjeshtë financiar dhe përgatitje të dokumentacionit të subvencioneve.
9. Zyra konsulence dhe auditimi – si ndihmës për përgatitjen e dokumenteve për klientë.
10. Sipërmarrje të vogla familjare – për ndihmë në menaxhimin e thjeshtuar të veprimtarisë ekonomike

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit profesional 2-vjeçar “Ndihmës Ekonomist” fitojnë njohuri në bazat e ekonomisë, kontabilitetit, sistemit të tatimeve, administrimit të biznesit, raportimit financiar dhe komunikimit profesional, duke u pajisur me aftësi konkrete që i përgatisin për përfshirje të menjëhershme në tregun e punës.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (plani mësimor)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i parë				
1.	Bazat e Ekonomisë	6	60	I
2.	E drejta e punës	6	60	I
3.	Instrumenta Kalkulues në Biznes	6	60	I
4.	Baza Ligjore e Kontabilitetit	6	60	I
5.	Komunikimi në biznes	6	60	I
6.	Bazat e financës	6	60	II
7.	Kontabiliteti Financiar	6	60	II
8.	Njohuri mbi sistemin e tatim taksave	6	60	II
9.	Njohuri për programet financiare	6	60	II
10.	Gjuhë e huaj: - Anglisht - Frëngjisht - Italisht	6	60	II
Gjithsej viti i parë		60 ECTS	600	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Bankat dhe sistemi financiar	6	60	I
2.	Kontabiliteti aplikativ	6	60	I
3.	Llogaritja dhe regjistrimi i shpenzimeve	6	60	I
4.	Menaxhim Biznesi	6	60	I
5.	Lëndë me zgjedhje	6	60	I
	- Shkrim dhe Menaxhim Projektesh - Baza të Statistikës - Financa Personale			II
6.	Hyrje në informatikë	6	60	II
7.	Bazat e marketingut	6	60	II
8.	Praktikë profesionale	12	300	II
9.	Detyrime përmbyllëse	6	50	
Gjithsej viti i dytë		60 ECTS	770	
Total : viti I + viti II		120 ECTS	1370	-